



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:066221
Datë: 05.06.2024
Numri i dokumentit: 05785841

PA1.nr.815/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, departamenti i përgjithshëm, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Mehmet Ndrecaj - kryetar i kolegjit, Ferit Osmani dhe Zyhdi Haziri- anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Rrezarta Bala, në çështjen penale ndaj të akuzuarit B. G. , nga P. N. K. nga V. L. H. nga V, Sh. A. nga S, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Vjedhje e rëndë nga neni 327 par. 1 nën par.1.lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe të akuzuarit B. Z. për shkak të veprës penale Ndhurma, nga neni 33 në kryerjen e veprës penale Vjedhje e rëndë, nga neni 327 par.1 pika 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri P.nr.604/20, datë 08.04.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur konform të dispozitës së nenit 390 të KPRK-së, më datë 21.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri P.nr.604/20, datë 08.04.2022, **VËRTETOHET.**

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri P.nr.604/20, datë 08.04.2022, të akuzuarin B. G. , N. K. , L. H. dhe Sh. A. për shkak të veprës penale Vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nën par.1.lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe të akuzuarin B. Z. për shkak të verës

penale Ndhima nga neni 33 në kryerjen e veprës penale Vjedhje e rëndë, nga neni 327 par.1 në par.1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, konform nenit 363 par. 1 nënpar. 1.3 të KPRK-së i ka liruar nga akuza, me arsyetimin që nuk është provuar se të akuzuarit kanë kryer veprat penale të cilat iu vihen në barrë. Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko civil. Shpenzimet e procedurës penale kanë rënë në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka ushtruar:

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës aktgjykimin e ankimuar ta anuloj dhe lënda t'i kthehet shkallës së parë në rigjykim.

Përgjigje në ankesën e Prokurorit ka ushtruar mbrojtësja e të akuzuarit Sh. A. - avokate K. B. P. , me propozim që ankesa e Prokurorit të refuzohet dhe aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Prokuroria e Apelit me parashtrësën PPA/ii.nr. 854/2022 të datës 28.06.2022, ka propozuar që ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë të aprovohet si e bazuar, aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje. Ndërsa ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa në përgjigjen e Prokurorit e ushtruar nga mbrojtësja e të akuzuarit Sh. A. - avokate K. B. P. .

Gjykata e Apelit e Kosovës konform dispozitës së nenit 390 të KPP-së, caktoi seancën e kolegjit, për të cilën me kohë dhe në mënyrë të rregullt njoftoi palët. Në seancë ishin të ftuar, Prokurori i Apelit, të akuzuarit B. G. , N. K. , L. H. dhe Sh. A. , si dhe i akuzuari B. Z. dhe mbrojtësja e të akuzuarit Sh. A. -avokate K. B. P. të dëmtuarin H. M. . Në seancë prezantuan i dëmtuari H. M. dhe i akuzuari B. G. , ndërsa Prokurori i Apelit dhe palët tjera nuk prezantuan në seancë edhe pse janë njoftuar me kohë dhe në mënyrë të rregullt, mungesat e tyre nuk i kanë arsyetuar. Gjyqtari referues e referoi lëndën penale. I dëmtuari H. M. në deklarin e tij ka theksuar se i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe kërkon kompensim dëmi. Ndërsa i akuzuari B. G. në deklarin e tij ka theksuar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në ankesë dhe kërkon që të refuzohet ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë dhe të vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitat e nenit 394 të KPP-së dhe pasi vlerësoj pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë sa i përket vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike duke pretenduar që gjendja faktike është vërtetuar gabimisht dhe nuk përputhet me të vërtetën në rastin konkret Veprat penale Vjedhje e Rëndë nga neni 327 par.1 pika 1.1 me nenin 31 të KPRK-së është vërtetuar në bazë të raporteve policore të datës 29.12.024, deklaratës së të dëmtuarit H. M. , si dhe deklaratave të pandehurve si dhe shkresat e tjera të lëndës me foto dokumentacionin të bashkangjitur me aktakuzë, në këtë çështje penale, Në bazë të deklaratave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjegjësisht deklaratave të pandehurve, është vërtetuar se të pandehurit me datë 20.02.2014 rreth orës 03:00 në fshatin Bequk Komuna e Vushtrrisë, pas një marrëveshje paraprake kanë kryer Vjedhjen e Rëndë, ku kanë përdorur një mjet të papërshtatshëm për thyerjen e dyerve të shtallës të pronarit-të dëmtuarit H. M. , duke i vjedhur dy lopë në vlerë rreth 1.500 euro, kurse B. Z. dhe I. Z. , të njëjtën ditë dhe në të njëjtën kohë i kanë ndihmuar të pandehurve të lartëcekur si dhe kanë bërë roje me automjetin Golf. I akuzuari B. Z. në deklaraten e tij të dhënë në stacionin policor e pranon se e ka kryer Veprën Penale dhe se në ditën kritike ka qenë me I. Z. duke bërë roje dhe me këtë kanë ndihmuar me rastin e vjedhjes së lopëve. I akuzuari L. H. thekson se ka dëgjuar se N. K. dhe Bekim Gashi kanë vjedhur lopë. Personat tjerë, respektivisht të akuzuarit tjerë janë mbrojtur në heshtje e krejt kjo me qëllim të shmangies së përgjegjësisë penale. Gjykata ka konstatuar se mungojnë provat dhe se të akuzuarit nuk e kanë kryer veprën penale për të cilën ngarkohen, që vendimi i cili është sjellë është shumë i parakohshëm dhe pa arsyetim bindës. Nga këto arsye konsideroj se ankesa është e arsyetuar, e bazuar në faktet dhe në prova në shkresat e lëndës dhe se aktgjykimi i ankimuar është absolutisht i papranuar. Nga gjitha këto propozon që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit gjen se këto pretendime ankimore të prokurorit nuk qëndrojnë, ngase sipas shkresave të çështjes gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe se kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se në këtë drejtim asnjë fakt nuk ka ngelur në mëdyshje sikurse pa të drejtë pretendohet në ankesën e ushtruar. Se të akuzuarit nuk u janë gjetur elemente të kryerjes së veprave penale, gjendjen e tillë faktike gjykata e shkallës së parë e vërtetoj nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor si ato personale dhe ato materiale e siç janë: deklaratat e të dëmtuarit- H. M. , mbrojtja e të akuzuarit B. G. dhe në shqyrtimin gjyqësor, raporti i policor i datës 29.12.2014, raporti i oficerit 20.02.20214, raporti policor 20.02.2014, raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes i datës 27.02.2014, procesverbali mbi marrjen në pyetje të të pandehurit L. H. i datës 12.06.2020, procesverbali mbi marrjen në pyetje të të pandehurit N. K. i datës 17.07.2020, procesverbali mbi marrjen në pyetje të të pandehurit B. Z. i datës 03.07.2020 procesverbali mbi marrjen në pyetje të të pandehurit Sh. A. i datës 26.06.2020, foto dokumentacioni në shtojcë prej 17 fotografive, aty të akuzuarit N. K. , L. H. , B. Z. dhe Sh. A. janë mbrojtur në heshtje. Me të drejtë sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë drejt ka ardhur në përfundim se nuk është provuar se në veprimet e të akuzuarve plotësohen elementet subjektive dhe objektive të veprave penale për të cilat janë liruar nga akuzua. Si të drejtë dhe të ligjshëm kolegji penal i kësaj gjykate e morri konstatimin e gjykatës së shkallës së parë se pas administrimit të provave, analizimit të tyre me shumë kujdes gjatë shqyrtimit gjyqësor, ka ardhur

në përfundim se nuk është provuar se të akuzuarit me datë vend dhe kohë si në pikën I dhe II të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar të kenë kryer veprat penale për të cilat janë akuzuar me aktakuzën e prokurorisë. Konstatimin e gjykatës së shkallës së parë se pas vlerësimit të provave të administruara ka kontestuar faktet jokontestuese dhe ato kontestuese, dhe pas vlerësimit të provave të administruara lidhur me faktet kontestuese ka dhënë një arsytim të drejtë dhe të ligjshëm dhe si të tillë e aprovojë Kolegji Penal i kësaj Gjykate në rastin konkret ka vlerësuar se në mungesë të provave nuk është dëshmuar se të pandehurit i kanë kryer veprat penale për të cilat akuzohen, pasi që nuk është vërtetuar me asnjë provë se të pandehurit natën kritike kanë qenë në fshatin Beçuk dhe e kanë kryer këtë vepër, e vetmja provë që i lidh të pandehurit me veprat penale për të cilat akuzohen është deklarata e të pandehurit B. Z. , e dhënë në Stacionin Policor në Vushtrri edhe pse në këtë deklaratë i pandehuri në asnjë rast nuk e ka pohuar faktin se ka qenë në fshatin Beçuk, në bazë të së cilës edhe është ngritur aktakuza, deklaratë kjo e cila më vonë është mohuar nga i akuzuari, përkatësisht me deklaratën e dhënë me datë 03.07.2020 gjatë marrjes në pyetje nga Njësia e Hetimeve në Vushtrri. Andaj gjykata në kuptim të nenit 262 par. 1 dhe par. 2 të KPPK-së, në të cilin është përcaktuar se “1. Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një dëshmi ose duke i dhënë rëndësi vendimtare një dëshmie apo një prove tjetër e cila nuk mund të kundërshtohet nga i pandehuri ose mbrojtësi përmes marrjes në pyetje gjatë ndonjë faze të procedurës penale” dhe “2. Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një deklaratë ose duke i dhënë rëndësi vendimtare deklaratimit të dhënë nga i pandehuri në polici ose para prokurorit të shtetit.”, e po ashtu lidhur me nenin 126 par. 5 të KPPK-së ku është përcaktuar se “Deklaratat e dhëna nga i pandehuri në çfarëdo konteksti, nëse janë dhënë në mënyrë vullnetare dhe pa shtrëngim, janë prova të pranueshme gjatë shqyrtimit kryesor kundër të pandehurit, por jo edhe kundër të bashkëpandehurve. Deklaratat e tilla nuk mund të shërbejnë si provë e vetme fajësuese apo vendimtare për dënimin e të pandehurit”, dhe duke u bazuar në arsyet e cekura më lartë gjykata i ka liruar të akuzuarit nga akuza. Po ashtu gjykata në rastin konkret sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë drejt ka zbatuar edhe e dispozitat e nenit 3 të KPPK-së, përkatësisht parimin *in dubio pro reo* ku në paragrafin 2 të këtij neni është përcaktuar se “Mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas Kodit dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës”. Një gjendje të tillë faktike si të drejt dhe të ligjshme e aprovon edhe kolegji penal i kësaj gjykate.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
PA1.nr.815/22, më datë 21.03.2024

Zyrtarja ligjore:
Rrezarta Bala

Kryetari i kolegjit:
Mehmet Ndrecaj

Numri i lëndës: 2020:066221
Datë: 05.06.2024
Numri i dokumentit: 05785841

Anëtarët e kolegjit:

Ferit Osmani

Zyhdi Haziri